- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më

vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Tabela nr.1

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Për t'u plotësuar nga operatori ekonomik

Mbështetur në Udhëzimin nr.6, datë 26.11.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar

Tabela nr.2

"Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të Ndërmarrjes së Shërbimeve të Gjellbërimit, Higjenës dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier"				
Nr.	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH
1			1	
2			1	
3			1	
etj.			1	
Shumatorja e çmimeve për njësi (pa TVSH)				

Kjo tabelë do të plotësohet për secilin mjet.

***Shënim:**

❖ **Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë të dyja tabelat e mësipërme, tabelën nr.1 (lista e çmimeve) për vlerën totale të ofertës sipas Shtojcës 2 dhe tabelën nr.2 për shumatoren e çmimeve për njësi (pa TVSH), për secilin mjet. Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë gjithashtu edhe Tabelën Përmbledhëse për shumatoren e çmimeve për njësi, për totalin e mjeteve.**

❖ Mbështetur në Udhëzimin nr.6, datë 26.11.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar, duke qenë se objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me çmim për njësi.

❖ **Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përlogaritur për totalin e mjeteve.**

❖ Vlera totale e ofertës së paraqitur nga Ofertuesi, nuk duhet të kalojë vlerën e pritshme të kontratës (*fondin limit total*). Tejkalimi i vlerës së pritshme të kontratës (*fondit limit total*) përbën kusht skualifikimi.

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim:

Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kerkuar ne dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publike dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj*** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës. Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Filtrat e mjeteve duhet të jenë cilësor dhe të shoqëruar me certifikatën CE **(ose ekuivalente)**.

2. Ndërrimi i filtrave do të kryhet në varësi të kilometrave.

3. Shërbimet e tjera të mjeteve do të kryhen gjatë gjithë periudhës me akt konstatimet e difekteve dhe me miratimin e specialistëve të AK.

4. Në rastet e ndodhjes së difekteve të mjeteve në qarkullim brenda ose jashtë territorit të Bashkisë Fier, operatori ekonomik ofertues duhet të kryejë me shpenzimet e veta transportin e mjeteve pranë servisit.

5. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të bërë verifikimin e objektit (servisit), makinerive dhe pajisjeve të sipër përmendura sipas këtyre kërkesave.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: **Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të Ndërmarrjes së Shërbimeve të Gjellbërimit, Higjenës dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier**

Afatet e ekzekutimit: **Afati i marrëveshjes kuadër është 1 vjeçare**

AUTO KARRO SHEFENG me numër shasie 79GCJ31814903114 viti i prodhimit 2007 metargë AA 958 AO

Nr. 1	Emërtim	Njësia	Sasia
1	F.V.Filtër nafte	copë	1
2	F.V.Filtër ajri	copë	1
3	F.V.Filtër vaj motorri	copë	1
4	F.V.Ferrotë të para	set	1
5	F.V.Ferrotë të dyta	set	1
6	F.V Gjenerator	copë	1
7	Riparim motorrino	shërbim	1
8	F.V.Pompë uji	copë	1
9	F.V.Këmbë kambio	copë	1
10	F.V.Këmbë motorri	copë	2
11	Riparim kambio	shërbim	1
12	F.V.Llamba	copë	8
13	F.V.Kryq transmisioni	copë	2
14	F.V.Pompë alkoli	copë	1
15	F.V.Set freksioni	set	1
16	Riparim leva e marshit	shërbim	1

AUTO KARRO SHEFENG me numër shasie 50206984 viti i prodhimit 1998 me targë FR 914 AD

Nr. 2	Emërtim	Njësia	Sasia
1	F.V.Filtër nafte	copë	1
2	F.V.Filtër ajri	copë	1
3	F.V.Filtër vaj motorri	copë	1

4	F.V.Set freksioni	set	1
5	F.V.Brave dere	copë	2
6	F.V.Llampa	copë	8
7	Riparim kambio	shërbim	1
8	F.V.Këmbe motorri	copë	2
9	Riparim motorrino	shërbim	1
10	F.V.Pompë uji	copë	1
11	F.V.Këmbë kambio	copë	1

FURGON FORD TRANSIT me numër shasje YFOHXXGBYHPE32999 viti i prodhimit 2000 me targë AA 502 AY

Nr. 3	Emërtim	Njësia	Sasia
1	F.V.Filtër nafte	copë	1
2	F.V.Filtër ajri	copë	1
3	F.V.Filtër vaj motorri	copë	1
4	F.V Ferrota të para	set	1
5	F.V Ferrota të pasme	set	1
6	F.V Set freksioni	set	1
7	F.V.Koka moco	copë	2
8	F.V.Koka paraleli	copë	2
9	F.V.Amortizator të parë	set	1
10	Saldim marmite	shërbim	1
11	F.V.Disqe freni përpara	set	1
12	F.V.Gomina	copë	4
13	F.V.Nofull freni perpara	copë	2
14	Riparim gjeneratori	shërbim	1
15	Riparim motorrino	shërbim	1
16	Riparim i sistemit elektrik	shërbim	1
17	Riparim diferenciali i pasëm	shërbim	1
18	F.V.Këmbë motorri	copë	2
19	F.V.Këmbë kambio	copë	1

AUTOBOT TIP O.M me numër shasje 3601262 viti i prodhimit 1970 me targë FR6277C

Nr. 4	Emërtim	Njësia	Sasia
1	F.V.Filtër nafte	copë	1
2	F.V.Filtër ajri	copë	1
3	F.V.Filtër vaj motorri	copë	1
4	F.V.Llamba	copë	8
5	F.V.Pasqyra	copë	2
6	Riparim i depozitës të ujit	shërbim	1
7	F.V.Permistopa	copë	4

8	Saldim marmite	shërbim	1
9	Riparim i pompës së agregatit	shërbim	1
10	F.V.Ferota të para	set	1
11	F.V.Ferota të dyta	set	1
12	Riparim balestër	shërbim	1
13	F.V.Gomina balestre	set	1
14	F.V.Rubineta	copë	4
15	F.V. Guarnicion testate	copë	1
16	F.V.Pompë uji	copë	1
17	Riparim pastrim radiator uji	shërbim	1
18	Riparim diferenciali	shërbim	1

ZETOR me numër shasje 1050VDT viti i prodhimit 2000 me targë AFMB 83

Nr. 5	Emërtim	Njësia	Sasia
1	F.V.Filtër naftë	copë	1
2	F.V.Filtër ajri	copë	1
3	F.V.Filtër vaj motorri	copë	1
4	F.V.Filtër vaj hidrauliku	copë	1
5	Riparim i pistonit hidraulik	shërbim	1
6	F.V.Fshirëse xhami	copë	1
7	F.V.Pompë alkoli	copë	1
8	F.V.Gjenerator	copë	1
9	F.V.Motorrino	copë	1
10	F.V.Çelës komandimi (dy pozicione)	copë	1
11	F.V.Koka grasatimi	copë	10
12	F.V.Thika freze	copë	15
13	F.V.Krahë paraleli	copë	2
14	Riparim injektorësh	shërbim	1
15	F.V.Permistopa pistoni	copë	4
16	F.V.Shpërndarës hidraulik	copë	2
17	Saldim marmite	shërbim	1
18	F.V.Pasqyra	copë	2
19	Riparim diferenciali	shërbim	1
20	F.V.Rip motorri	copë	1
21	Pastrim i radiatorit të ujit	shërbim	1
22	Pastrim i radiatorit të vajit	shërbim	1
23	Riparim i spinotave	shërbim	1
24	Riparim i bokullave	shërbim	1
25	F.V.Set permistopa pistoni	copë	4

AUTOBOT UJI RENAULT me numër shasje VF640ACB000004410 viti i prodhimit 1976 me targë AA 378 BZ

Nr. 6	Emërtim	Njësia	Sasia
1	F.V.Filtër nafte	copë	1
2	F.V.Filtër ajri	copë	1
3	F.V.Filtër vaj motorri	copë	1
4	F.V.Ferota të para	set	1
5	F.V.Ferota të dyta	set	1
6	Riparim kambio	shërbim	1
7	Riparim i sistemit elektrik	shërbim	1
8	F.V.Këmbë motorri	copë	2
9	F.V.Këmbë kambio	copë	1
10	Saldim marmite	shërbim	1
11	F.V.Rubineta	copë	4
12	F.V.Fshirëse xhami	copë	2
13	F.V.Stopa	copë	2
14	Riparim i pompës së naftës	shërbim	1
15	Riparim radiator uji	shërbim	1
16	F.V.Pompë alkoli frenash	copë	1
17	F.V.Valvul ajri (freni)	copë	2
18	F.V.Balestër (fijet e balestrës)	copë	8
19	F.V.Amortizatorë të pare	copë	2
20	Riparim diferenciali	shërbim	1
21	Riparim motorri	shërbim	1

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të Ndërmarrjes së Shërbimeve të Gjelbërimit, Higjenës dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier**

Detyrat:

1. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë, pranë autoritetit kontraktor pjesët e zëvendësuar të automjeteve.
2. Operatori ekonomik duhet të garantojë ruajtjen dhe sigurimin e mjeteve gjatë procesit të riparimit deri në dorëzimin e tyre. Për këtë duhet që servisi të jetë i mbikëqyrur sipas të gjitha standardeve më të mira (me kamera vëzhgimi apo me roje, etj). Operatori ekonomik mban përgjegjësi për dëmtimin duke e zhdëmtuar AK në vlerën e dëmit të shkaktuar, gjatë kohës që e ka marrë në dorëzim sipas objektit të prokurimit.
Operatori ekonomik mban përgjegjësi për vjedhjen apo humbjen e mjetit, gjatë kohës që e ka marrë në dorëzim sipas objektit të prokurimit, sipas vlerës të kontabilizuar të mjetit.
Operatori ekonomik mban përgjegjësi për çdo dëmtim të mundshëm, ndaj AK apo të tretëve, gjatë transportit të mjeteve drejtë servisit apo gjatë transportit të mjeteve kur del nga servisi, gjatë kohës që e ka marrë në dorëzim sipas objektit të prokurimit.
3. Riparimi duhet të fillojë jo më vonë se 24 orë nga koha e paraqitjes së automjetit për riparim. Koha e riparimit do të përcaktohet në preventiv apo procesverbal të mbajtur mes paleve, por jo më shumë se **3 ditë** për difekte xhenerike dhe jo më shumë se **7 ditë** për difektet e tjera.
4. Në përfundim të procesit të riparimit, do të kryhet përsëri kontrolli në pajisjet diagnostikuese dhe do të nxirret raporti i të dhënave teknike pas riparimit. Puna e kryer do të quhet e mirëqenë dhe shërbimi do të quhet i kryer, kur ajo të miratohet në zëra dhe në cilësi nga përfaqësuesi i autorizuar i Autoritetit Kontraktor.
Situacioni do të firmoset nga Komisioni i Marrjes në Dorëzim i autorizuar nga AK në zbatim të kontratës së Marrëveshjes Kuadër, në përbërje të të cilit ka specialist të fushës përkatëse, si dhe do të firmoset nga punonjësi i riparimit dhe drejtuesi teknik i operatorit ekonomik. Operatori Ekonomik do të lëshojë faturën tatimore duke e shoqëruar me garancinë e punimeve.
5. Në emimin e ofertuar për çdo material, pjesë këmbimi apo shërbim, etj., përfshihet edhe kosto e punës për kryerjen e shërbimit (heqje/vendosje e materialit, pjesës së këmbimit, etj.), të gjitha taksat, tatimet dhe shpenzime të tjera, me përjashtim të TVSH.
6. Të gjitha pjesët e këmbimit të jenë origjinale të vërtetuara me certifikatë origjine. Vendosja e pjesës së këmbimit do të bëhet në prani të përfaqësuesit të autorizuar të Bashkisë Fier dhe këtij të fundit do ti dorëzohen kutitë e pjesëve të reja të vendosura në automjet.

-
7. Në rast të përsëritjes së të njëjtit difekt, apo shkaktimit të difekteve të reja, që mund të kenë rrjedhur si pasojë e këtij difekti të riparuar me mangësi, shërbimet do të kryhen nga operatori ekonomik pa pagesë.

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: **Servisi i Operatorit Ekonomik me të cilin do të lidhet Marrëveshja Kuadër.**

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Licencë, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1, për ushtrimin e veprimtarisë servis automjetesh.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit **(2023, 2024)** lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **700 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohej dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **300 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:

- a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasitë e mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

ose

- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori/ët Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punëtore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej jo më pak se **7 (shtatë) punonjës** për **muajin Mars 2025.** Në këtë numër përfshihet dhe stafi drejtues.

Shënim: Për pikën **2.3.2** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohej në pikën **2.3.2**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Mars 2025.**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për **muajin Mars 2025.**

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një Përgjegjës (Drejtues) Teknik të shoqërisë, i cili duhet të jetë i pajisur me:

Dëshmi Aftësie Profesionale (DAP) të veprimtarisë së auto riparimit (*referuar Ligjit Nr.9573, datë 03/07/2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” të ndryshuar, (Kategoria VII.3.B.1).*

Shënim: Për pikën **2.3.3** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohej në pikën **2.3.3**, më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësura me origjinalin.

2.3.4 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar

Operatorët ekonomikë pjesmarrës duhet të kenë të punësuar inxhinierë dhe specialistë të kualifikuar për realizimin me cilësi të shërbimeve të kërkuara, si më poshtë:

a)1. Inxhinier mekanik	1 (një)
b)	
1. Punonjës mekanik	2 (dy)
2. Xhenerik	1 (një)
3. Motorrist	1 (një)
4. Elektroauto	1 (një)
5. Saldator	1 (një)

Operatorët ekonomikë pjesmarrës duhet të paraqesin një listë të punonjësve me profesionet përkatëse që ushtrojnë, përfshirë të gjitha profesionet e kërkuara nga AK më sipër.

a)-Për inxhinierin mekanik duhet të paraqesin bashkëlidhur:

- Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme),
- *Diplomë universitare,*

b)-Për specialistët duhet të paraqesin bashkëlidhur:

- Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme),
- *Dokument që të vërtetojë kualifikimin sipas profilit të kërkuar (diplomë ose certifikatë profesionale ose dëshmi kualifikimi, etj.)*

Shënim: Për pikat **a)** dhe **b)** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në shkronjat **a) dhe b)** të pikës 2.3.4, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

2.3.5 Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme/ambjente, për përmbushjen e shërbimeve të kërkuara në perputhje me specifikimet teknike apo termat e referencës të dhëna në DST, si më poshtë:

- a. Vinxh Urë mbi 3 Ton min. 1 (një),
- b. Pajisje (*kompjuter*) për kontrollin dhe testimin (*diagnostikimin*) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit min. 1 (një),
- c. Pajisje e testimit për kontrollin fizik në sistemin e drejtimit dhe amortizimit për mjetet e rënda (*konvergjencës së mjeteve*) min. 1 (një)
- d. Repart motorrik për kontrollin e motorrave me bango-provë, pajisje kontroll injektorësh, sistemit ftohës dhe testate min. 1 (një)
- e. Repart xhenerik të kompletuar min. 1 (një)
- f. Repart elektroaut të kompletuar min. 1 (një)
- g. Repart saldimi të kompletuar (*saldim elektrik, argon dhe oksigjen*) min. 1 (një)
- h. Mjet transportues për transportin e mjeteve të rënda deri në servis pa pagesë min. 1 (një) (*pronësi ose me qera*)

Shënim: Për pikën 2.3.5 **a), b), c), d), e), f), g), h)** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.5 a), b), c), d), e), f), g), h)**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumenta zyrtare që vërtetojnë se këto pajisje i ka në pronësi aktualisht (*dokumenta që vërtetojnë blerjen, faturat e blerjes*) **ose** të pasqyruara në bilancin e shoqërisë me zëra të veçantë **ose** i ka marrë me kontratë qeraje të vlefshme. Në rastin kur janë marrë me qira duhet të paraqitet kontrata e qiramarrjes e vlefshme deri në përfundimin e marrëveshjes kuadër.

2.3.6 Operatori ofertues duhet të ketë në pronësi **ose** me qira një objekt (*servis*) për realizimin e kontrates, të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit për realizimin e kontratës, dhe të ketë territor të mjaftueshëm për parkimin e mjeteve për kohën që është e nevojshme. Në rastin e ndodhjes së servisit jashtë territorit të Bashkisë Fier, operatori ekonomik do të marrë përsipër të kryejë me shpenzimet e veta transportin vajtje – ardhje të automjeteve që kanë nevojë për shërbime.

Shënim: Për pikën 2.3.6 si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.6** duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Për këto operatori duhet të paraqesë: foto të objektit (*servisit*) ku të pasqyrohen ambjentet e brendshme, repartet, ambjentet e jashtme, etj., si dhe dokumentin e pronësisë për servisin (*shoqëruar me hartën treguese hipotekore*) ose kontratën noteriale të qirasë me afat deri në përfundim të marrëveshjes kuadër për objektin që prokurohet.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën që përpara vlerësimit të ofertave, të verifikojë në vend repartet, mjetet, pajisjet teknike dhe të gjitha ambjentet e servisit të sipercituara, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve të kërkuara.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se të gjitha pjesët e këmbimit objekt prokurimi, që do të përdoren për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, do të jenë origjinale, të reja dhe prodhim sipas standarteve të CE **ose ekuivalente me to**, dhe se operatori ekonomik merr përsipër garancinë e pjesëve të këmbimit për jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) muaj, nga data e montimit ose vendosjes, në përputhje me normativat standarde të mirëmbajtjes së automjeteve, bazuar në km të përshkuar.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve, përkatësisht:

- Certifikatë ISO 14001:2015 për menaxhim mjedisi (të vlefshme) ose ekuivalente të saj.
- Certifikatë ISO 45001:2018 për sistemimin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë ose ekuivalente të saj.

e vlefshme, për objektin që prokurohet (*të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara*), të lëshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Ndërkombëtare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
